



Prishtinë, 28 prill 2011
Kodi i ZRRE-së: V_363_2011

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e Nenit 8 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, Nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.16 dhe 2.17, dhe Nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185);
- Dispozitat e Nenit 49.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Dispozitat e Nenit 4 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes; dhe
- Kërkesën e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK Sh.A) për derogim (shtyrje afati) në zbatimin e disa dispozitave të Kodit të Shpërndarjes, të datës 31 mars 2011,

Në seancën e mbajtur me datë 28 prill 2011, nxori këtë:

VENDIM

- I. **I LEJOHET** Korporatës Energjetike të Kosovës derogimi në zbatimin e disa neneve dhe dispozitave të Kodit të Shpërndarjes si në Shtojcë të këtij vendimi .

Arsyetim

- Korporata Energjetike e Kosovës (KEK Sh.A), me datë 31 mars 2011 ka dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) kërkesën për derogim të disa dispozitave të Kodit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.
 - ZRRE ka analizuar dispozitat dhe arsyetimin e paraqitur në kërkesën e KEK-ut, dhe bazuar në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të tij.
- II. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
 - III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
 - IV. Vendimit i bashkëngjitet Shtojca me dispozitat për të cilat është lejuar derogim.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar



Shtojcë – Tabela me dispozitat për të cilat është lejuar derogim

Kodi i Shpërndarjes				
Nr.	Dispozita	Kërkuar deri më:	Lejuar deri më:	Arsyetimi i KEK-ut
1.	5.7 Matja/Telematja	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2011	KEK-u ende nuk ka të instaluar ndonjë sistem për telekontrollim siç është SCADA, po ashtu edhe përdoruesit nuk kanë pajisje për telekontrollim.
2.	6.4 Komunikimi Operues dhe Veprimi	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2011	OSSH është duke punuar për formimin e Qendrës Dispeçerike dhe implementimit të pajisjes SCADA.
3.	6.6 Testimi i Sistemit	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2011	Përcaktimi i konfigurimit optimal të rrjetës distributive është detyrë komplekse që përcakton minimizimin e humbjes së fuqisë dhe energjisë, besueshmëri më e madhe e rrjetit, izolim termik i kablllove, rënia e tensioneve etj. Të gjitha këto mund të realizohen me testime teknike simuluese, atëherë kur ndërtohet Qendra Dispeçerike në Distribucion dhe me implementimin e pajisjes SCADA.